



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Nga: Mirand Tafarshiku – Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit dhe Analizës

Për: Niman Racaj – Drejtor i Departamentit Ligjor

Lënda: Raporti i Monitorimit lidhur me Ankesën nga Devolli Grup ndaj RTK 1

Gjetjet: Në shkelje të Kodit të Etikës (KKPM-2016/03) për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 5.2, 5.5, 6.1, 7.6;

Datë: 09.06.2020



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më datë 11.05.2020, ka pranuar një ankesë nga Devolli Grup (më tutje Pala Ankuese) ndaj emisionit “Jeta në Kosovë” të transmetuar në RTK1 me datën 30.04.2020.

Sipas Palës Ankuese, gjatë gjithë transmetimit të këtij emisioni përdoret një gjuhë denigruese e me qëllim të dëmtimit të imazhit të kompanisë dhe pronarit z. Blerim Devollit.

Më tej, në ankesë theksohet se ky emision vazhdimisht bën cilësime në drejtim të kompanisë dhe Blerim Devollit duke përdorur fraza si “Baba Blerim Devolli”, “Nanë Blerim Devolli”, “ tu i qeru si kepen e gjen qe e kanë nanë Blerim Devollin“, “Devollëve t’shkretë”, “Qe çka bon shteti i fortë për Devollët e shkretë” etj. si dhe në disa raste përmendet “skema e fshehjes së pronarëve të vërtetë”, e cila sipas Palës Ankuese është e pavërtetë dhe tendencë për ta paraqitur Blerim Devollin si të inkriminuar në punë të jashtëligjshme.

Në ankesë theksohet se tendencë e këtij emisioni ishte të përçojë tek shikuesi që Blerim Devolli është duke përfituar nga “xhepi i konsumatorit”, duke përdorur fraza me të cilat mundohet të bindë shikuesin për diçka që nuk qëndron.

Po ashtu, në ankesë pala ankuese përmend se gjatë emisionit, autorët e emisionit kujdesen që të përmendin kush është Blerim Devolli duke përdorur të pavërteta dhe gjuhë denigruese ndaj tij si:

”të mirremi vesh, qeky asht Blerim Devolli që o thirr prej parlamentit të kalum me dëshmu në komisionin hetimor, si pronar i Zmobile, se qysh e ka dëmtu Valën e Kosovës, njeri o i talentum, hem me energji solare, hem me telefoni, hem me jastika e dysheka, hem me kafe, hem amel edhe plus shtetas malazez, resident i Pejës por me pushime në Maltë”.

Në ankesë thuhet se janë bërë një varg shkeljesh të Ligjit për RTK-në, përkatësisht neni 9, pika 1.3 dhe 1.5; neni 18, pika 2.1, pika 5 dhe pika 6; si dhe shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM – 2016/03, përkatësisht neni 3, pika 3; neni 5, pika 2 dhe pika 5; neni 6, pika 1; neni 7, pika 5 dhe 6.

Lidhur me ankesën në fjalë, më datën 14 maj 2020 në afat prej tri (3) dite, DMA ka kërkuar nga RTK 1 sqarim lidhur me ankesën e parashtruar nga Pala Ankuese. Ndërkohë që RTK1 përmes emailit ka kërkuar nga KPM afat shtesë për përgjigjen për rastin e apostrofuat e cila i është mundësuar nga ana e KPM-së.

Më datë 27 maj 2020, RTK1 ka ofruar sqarimet lidhur me ankesën në fjalë.

Sipas sqarimit nga RTK1, thelbi i emisionit ka të bëjë me faktin sesi 6 kompani në pronësi të B.Devolli kanë përfiturat tarifa nxitëse për prodhim të energjisë së ripërtitshme në total prej 16.7 megavat, ndërsa sipas vendimit të ZRrE-së përcaktohet se maksimumi për një aplikues duhet të jetë deri në 3 megavat. Në sqarimin e RTK1 theksohet se sipas hulumtimit regjistrimi i bizneseve në Maltë i ka mundësuar B.Devolli të përfitojë tarifa nxitëse për prodhim me energji solare me kapacitet 16 megavat, kapacitete që janë regjistruar në emër të bizneseve të ndryshme me të njëjtin pronar. Sipas RTK1, nga ky vendim është dëmtuar qytetari i Kosovës ndërsa janë favorizuar bizneset e një individi të caktuar. Në emision është ngritur shqetësimi se zhvillimi i këtyre procedurave krijon mundësi për krijim të monopolit për kompani të caktuara.

Në sqarimin e RTK1, ndër të tjera thuhet se: “E tërë përmbajtja dhe narracioni i emisionit në asnjë moment dhe asnjë mënyrë nuk ka konotacion ofendues ndaj Ankuesit, por synon të shpallë, thjeshtësoj dhe ilustroj kompleksitetin e skemës së fshehjes së bizneseve me qëllim të përfitimit.

Togëfjalshat si “Baba Blerim Devolli”, “Nanë Blerim Devolli”, “Tu i qeru si kepen e gjen që kanë nanë Blerim Devollin”, “Devollëve të shkretë”, “Qe çka bon shteti i fortë për Devollët e shkretë”, nuk synojnë Ankuesin, por “vizatojnë” skemën e mashtrimit përmes së cilës i është bërë i mundur përfitimi i Ankuesit në dëm të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës.

Secili togfjalësh i referuar ndaj Ankuesit, në fakt pasqyron - “vizaton” veprime dhe gjendje faktike të Ankuesit”.

RTK1 gjithashtu konsideron që provat e paraqitura në hulumtimin e emisionit tregojnë se me vendimin e ZRrE-së të datës 27 nëntor 2019, janë dëmtuar drejtpërsëdrejti interesat e qytetarëve

të Kosovës në njëren anë, ndërsa është favorizuar dhe u është mundësuar bizneseve të caktuara që të krijojnë terren për monopol.

Gjetjet nga monitorimit

Më datë 30.04.2020, RTK1 ka transmetuar emisionin “Jeta në Kosovë” me titull “Monopoli me dritë të diellit – ZRRE dhe Devolli”, në të cilin trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me tarifën nxitëse për energji solare, procedurat e zhvilluara nga ZReE-ja, si dhe çështjet që ndërlidhen me pronësinë e Palës Ankuese në kompanitë përfituese për zhvillim të aktiviteteve për prodhim të energjisë së ripërtitshme. Sipas të gjeturave të tyre, në këtë emision ngritet shqetësimi për dëmtrim të interesave të qytetarëve dhe favorizim të kompanive të caktuara përmes vendimeve të ndërmarra nga ZRrE-ja gjatë përcaktimit të tarifave dhe zhvillimit të procedurave për këto aktivitete nga ana e ZReE-së.

Gjatë gjithë transmetimit të emisionit është shfaqur në një kënd të ekranit hashtagu #mosmavjedhdiellin dhe gjithashtu janë përdorur këto shprehje gjatë referimit të Palës Ankuese si “baba Blerim Devolli”, “nanë Blerim Devolli”, “Devollë të Shkretë”, “Vazhdojnë me marr qet tarife nxitëse tu nejt, profit i mire a!”, “Konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë në mënyrë që me u përkrah 6 bizneset e Devollit”, “Nga xhepi i konsumatoreve në llogari të kompanive të Devollit do të derdhen 14.4 milion euro, “kanë me shku për bizneset e shkreta të Blerim Devollit”.

Në emision është theksuar se Palës Ankuese i janë dërguar pyetjet me datën 11 mars 2020 dhe është rikujtuar për to edhe një herë me datën 22 prill 2020. Po ashtu më herët me datën 24 shkurt 2020 i është dërguar kërkesë për intervistë, por nuk kanë marr përgjigje nga Pala Ankuese.

Konkluzion

Në bazë të monitorimit, si dhe analizës së ankesës dhe sqarimit të ofruar nga RTK1, DMA konsideron se lidhur me pretendimet për shkelje të Kodit të Etikës (KKPM-2016/03) për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, RTK ka vepruar në kundërshtim me:

- Nenin 5.2, duke vënë në pozitë denigruese, të pafavorshme, përqeshëse apo tallëse Palën Ankuese përmes përdorimit të shprehjeve si “Devollët e shkretë”, “Baba Blerim Devolli”, “Nona Blerim Devolli”, “Qe cka bon shteti i fortë për Devollët e shkretë etj..
- Nenin 5.5, pasi që përderisa tarifën nxitëse për prodhim të energjisë solare përfshirë edhe tarifën për pagesë të energjisë elektrike përcaktohen nga organi kompetent, në këtë rast ZRrE-ja, në emision përmes shprehjeve të përdorura si “Konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë në mënyrë që me u përkrah 6 bizneset e Devollit”, “Nga xhepi i konsumatoreve

në llogari të kompanive të Devollit do të derdhen 14.4 milion euro, “kanë me shku për bizneset e shkreta të Blerim Devollit” krijohet përshtypja që shkaktari për përcaktimin e këtyre tarifave është Pala Ankuese. Po ashtu, në emision është theksuar se Pala Ankuese ka dëmtuar Valën e Kosovës, përderisa nuk janë ofruar fakte nga organet kompetente që dëshmojnë këtë pretendim.

Shprehjet e tilla të përdorura në emision mund të nxisin urrejtje nga ana e publikut ndaj Palës Ankuese dhe mund të rezultojnë në veprime të dhunshme ndaj tij.

- Nenin 6.1, përmes raportimit të lajmeve të pasakta, duke theksuar se “Konsumatorët do të paguajnë më shtrenjtë në mënyrë që me u përkrah 6 biznese të Devollit” përderisa tarifët përcaktohen nga ana e ZRreE-së dhe këto tarifa nxitëse u paguhen të gjitha kompanive që merren me këtë veprimtari, duke e ndërlidhur për aktivitete biznesore Palën Ankuese për produkte si jastëk, dyshekë, kafe që nuk janë në pronësi të Palës Ankuese, duke akuzuar për dëmtim të Valës së Kosovës, përderisa nuk ka ofruar fakte lidhur me këtë të vërtetuar nga organet kompetente.
- Nenin 7.6, për shkak se në bazë të monitorimit shihet se edhe pse emisioni ka pasur për qëllim të trajtojë çështjet që kanë të bëjnë me vendimin e ZReE-së, që sipas RTK1 janë dëmtuar interesat e qytetarëve për shkak të tarifave të përcaktuara, si dhe lidhur me zhvillimin e procedurës për marrjen e vendimit për caktimin e tarifave nxitëse, në emision ndërlidhet roli i Palës Ankuese në këto procese, që në bazë të vlerësimeve të lartcekura, trajtimi i Palës Ankuese përmes përdorimit të shprehjeve ndaj tij, raportimit të lajmeve të pasakta ndaj tij etj. mund të konsiderohet se emisioni ka pasur qëllim të keq ndaj Palës Ankuese si dhe ka përmbajtur kritikizëm të padrejtë ndaj tij, veçanërisht kritikizëm për pjesën që ndërlidhet me përcaktimin e tarifave dhe procedurave të zhvilluara nga ana e ZReE-së. Po ashtu, në emision është aluduar për Palën Ankuese se “Vazhdojnë me marr qet tarife nxitëse tu nejt, profit i mire a!” duke mos ofruar fakte se kjo kompani përfiton siç thuhet në emision “tu nejt”.

Rekomandim

Lidhur me shkeljet e konstatuara në bazë të monitorimit të emisionit, analizimit të ankesës së parashtruar dhe sqarimit të ofruar nga RTK1, DMA i rekomandon Departamentit Ligjor marrjen e vendimeve ligjore.